



KUVENDI KOMUNAL PRISHTINE * MUNICIPALIT ASSEMBLY PRISHTINA * SKUPSTINA OPSTINA PRISTINA

Në bazë nenit 3.1 pika b dhe h, të Rregullorës mbi Vetëqeverisjen e Komunave të Kosovës nr. 2000/45 të dt. 11. gusht 2000 dhe nenit 19 al. 1. pika b dhe ë të Statutit dhe Rregullave të Procedurës të Komunës së Prishtinës të dt. 16.03.2001, Kuvendi i Komunës së Prishtinës në mbledhjen e mbajtur me dt. 27.12.2006 merr

V E N D I M

PËR ÇAKTIMIN E LOKACIONIT PËR NDËRTIMIN E OBJEKTIT TË QENDRËS TREGTARE DHE REALIZIMIN E TIJ NË BAZË TË KONTRATËS MBI KONCESIONIN

Neni 1

Miratohet Vendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit të qendrës tregtare dhe realizimin e tij në bazë të kontratës mbi koncesionin.

Neni 2

Lokacioni për ndërtimin e objektit nga neni 1 i këtij vendimi me sipërfaqe të përafërt prej 38.00 ari në pjesët e ngastrave katastrale 2628 dhe 2629, zona katastrale e Prishtinës lagja "Kodra e Diellit 2" në Prishtinë.

Ky vendim paraqet bazë për caktimin e kushteve urbanistiko - teknike në bazë të cilave do të hartohet dokumentacioni teknik për ndërtimin e objektit nga neni 1 i këtij Vendimi.

Neni 3

Realizimi i objektit nga neni 1 i këtij Vendimi do të bëhet në bazë të kontratës mbi koncesionin.

Përzgjedhja e koncesionarit do të bëhet përmes ofertave publike dhe procedurave tjera të parapara ligjore për dhënjen me koncesion.

Neni 4

Para nënshkrimit të kontratës me koncesionarin e zgjedhur sipas procedurës nga neni 3 i këtij Vendimi, kontratën do ta shqyrtoj dhe miratoj Komiteti për Politikë dhe Financa i Kuvendit të komunës së Prishtinës.

Neni 5

Për realizimin e objektit të planifikuar sipas këtij Vendimi dhe për përmbushjen e kushteve të përcaktuara me kontratën mbi koncesionin, do të kujdeset Kryeshefi Ekzekutiv i Komunës së Prishtinës përmes Bordit të Drejtoreve.

Neni 6

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e miratimit të tij.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS

01 NR. 353-587 DT. 27.12.2006

**KRYETARI I KUVENDIT
Ismet Beqiri**